6/6 KBU
17.5.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN**

**VENDIM**

Nr.**3**, datë **30/04/2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR (PUS-SHPIMI 1/ALB) PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT "K.I.D - ALB" SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50,të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, *"Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre"*, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Erzen,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë "K.I.D - ALB" sh.p.k, "Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor nëntokësor për qëllime industriale" (Fabrika e tullave), me vendndodhje, Maminas, Bashkia Shijak, Qarku Durrës.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit 1/ALB (KRGJSH)

-X= 465882.19; Y= 4581378.16; Z=20.28 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: Q=0.17 l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 30 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 25 m

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

-X= 465843.42; Y= 4581346.87; Z=20 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU ERZEN**

**AFRIM QËNDRO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT UJOR - ERZEN